

## NË EMËR TË POPULLIT

**Gjykata e Apelit e Kosovës** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Gani Zabeli, kryetar kolegji, Shqipe Qerimi e Ferit Osmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Jeton Leci, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit T.T. nga Prishtina, për shkak të kryerjes së veprës penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par. 1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit T.T., av.A.B., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.1853/15 të datës 19.09.2018. në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 26.11.2018, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit T.T. Tërmkollli, av.A.B., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.1853/15 të datës 19.09.2018, **vërtetohet**.

### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.1853/15 të datës 19.09.2018, i akuzuari T.T. Tërmkollli, është shpallur fajtor për shkak të kryerjes të veprës penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par. 1. të KPRK-së, dhe është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muaj, të cilin dënim do ta mbaj pas 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pasi që ky aktgjykim të ketë marrë formën e prerë. Me pëlqimin e të akuzuarit, konform nenit 47 par 1 të KPRK, dënimi me burg i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 1.500.00(njëmijë e pesëqind)€, të cilin dënim i pandehuri obligohet ta paguaj pas 15(pesëmbëdhjetë)ditëve pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Nëse dënimi i shqiptuar nuk paguhet i njëjti konform nenit 46 par 3 të KPRK, do të zëvendësohet me dënim me burg, ku një ditë me burg do të llogaritet me 20 (njëzet) € të gjobës. I akuzuari pagesën e dënimit mund ta bëj me 3 (tri) këste, më së largu me dt.05 të muajit vijues. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse kësti nuk do të paguhet me kohë. I akuzuari është i obliguar që ti paguaj shpenzimet procedurale aq sa të bëhen sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, për programin e kompensimit ti viktimave të krimit shumë prej 30 (tridhjetë) € dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 30 (tridhjetë) €, e të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Të dëmtuarit I.V., G.S. dhe N.I., për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur mbrojtësi të të akuzuarit Av. .A.B., për vendimin mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit ta miratoj ankesën si të bazuar, aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ta ndryshoj lidhur me masën dhe lartësinë e dënimit dhe ti shqiptoj një dënim më të butë alternativ-dënim me kusht.

Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim, PPA/II.nr.1127/2018, datës 20.11.2018, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit ndërsa aktgjykimi i ankimuar, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

**- ankesa nuk është e bazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit.

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, në fakt me ankesë as që ka mund të kontestohet ngase i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë dhe gjyqtari individual është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj aktgjykimi i kundërshtuar u vlerësua vetëm në drejtim të pretendimeve të paraqitura në ankesë.

Mbrojtësi i të akuzuarit me ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin nuk i ka vlerësuar drejtë në masë të duhur rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë, se është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale, se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale, si dhe premtimin e tij që në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe nuk do të kryej ndonjë vepër tjetër penale. Sipas ankesës së mbrojtësit këto janë rrethana që determinojnë në zbutjen e dënimit. Mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë i propozon gjykatës së Apelit që aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarit ti shqiptojë dënim më të butë alternativ- dënim me kusht.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtësit të të akuzuarit për një dënim më të butë, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse i ka konstatuar dhe drejt i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në pajtim me dispozitat e nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, duke i vlerësuar si rrethana lehtësuese faktin se i akuzuari ka bërë pranimin e fajësisë, se është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale, se më parë nuk ka qenë dënuar për ndonjë vepër tjetër penale, si dhe premtimin e tij se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm

se nuk do të kryej ndonjë vepër tjetër penale, kurse rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të lartcekura dhe se në ankesën mbrojtësit të të akuzuarit nuk theksohet asnjë rrethanë lehtësuese e cila nuk është vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë e që do të ndikonte në zbutjen e dënimit të shqiptuar ndaj të akuzuarit.

Prandaj, duke pas parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe drejt vlerësuar gjykata e shkallës së parë, edhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale dhe adekuat me përgjegjësinë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit- preventiva individuale dhe ajo e përgjithshme.

Nga sa u tha më lartë në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË**  
**PA1.nr.1123/18 me 26.11.2018**

**Bashkëp. profesional**

**Jeton Leci**

**Kryetari i kolegjit –gjyqtari**

**1. Gani Zabeli**

**Anëtarët e kolegjit**

**2. Shqipe Qerimi**

**3. Ferit Osmani**